

Programi IPA për shoqëri qytetare dhe media



POZICIONI I SHOQATËS TË QYTETARËVE (SHQ) “PROAKTIVA”

Lidhur me politikat kombëtare dhe komunale për efikasitet energjistik

Qershor 2017

Ky projekti është financuar nga
Bashkimi Evropian

Projektin e zbaton Shoqata e Qytetarëve
PROAKTIVA Shkup

Botues: Shoqata e Qytetarëve "PROAKTIVA " Shkup
P.fax 695, Shkup
Shkup, Republika e Maqedonisë
info@proaktiva.org.mk
www.proaktiva.org.mk

Në bashkëpunim me:

Shoqatën e Qytetarëve MILIEUKONTAKT Maqedoni,
Shoqatën e Qytetarëve KOCKA, dhe
Shoqatën e Qytetarëve FRONT 21/42

Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi e PROAKTIVA dhe assesit nuk mund të Konsiderohet se i reflekton këndvështrimet e Bashkimit Evropian.

Përmbajtja:

1.	<i>Parathënie</i>	4
2.	<i>Hyrje</i>	5
3.	<i>Politika kombëtare për efikasitet energjitik dhe burime ripërtëritëse të energjisë</i>	6
3.1.	<i>Politika të përgjithsme kombëtare për efikasitet energjitik dhe burime ripërtëritëse të energjisë</i>	7
3.2.	Plani i parë aksional për efikasitet energjitik në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2018	13
3.3.	Strategji për avancimin e efikasitetit energjitik në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2020	17
3.4.	Strategji kombëtare për shfrytëzimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë deri në vitin 2020	20
4.	<i>Politika komunale për efikasitet energjitik</i>	23
4.1.	Dokumente strategjike komunale për zhvillimin e efikasitetit energjitik dhe burimeve ripërtëritëse të energjisë	24
4.2.	Sfida dhe praktika të mira të komunave për zbatimin e masave për efikasitet energjitik.....	29
4.3.	Qasja në informacione	33
5.	<i>Konkluzione</i>	35

1. Parathënie

PROAKTIVA Shkup është shoqatë e qytetarëve e formuar në vitin 2001. Përkundër numrit të madh të inxhinierëve për mjedisin e jetesës, organizata përfshin edhe studentë të diplomuar nga sfera e shkencave natyrore dhe elektro-teknike. Misioni i PROAKTIVA-s është që të planifikojë dhe zbatojë aktivitete që do t'i përmbushnin nevojat e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në fushën e efikasitetit energjistik, burimeve ripërtëritëse të energjisë dhe transportit afatgjatë.

Në kuadër të projektit "Organizata të përforcuara qytetare për transponimin e pjesërishtëm dhe zbatimin e BE 2020 pakos për energji dhe klimë" të koordinuar nga ana e MILIEUKONTAKT Maqedoni, KOCKA dhe FRONT 21/42, PROAKTIVA fitoi grant i cili kontribuoi drejt përfundimit të sektorit civil për inkuadrimit aktiv në miratimin dhe zbatimin e dokumentave lokale dhe politikave për klimën dhe energjinë dhe nxitjen e Njësive të vetëqeverisjes lokale për zbatimin thelbësor të Konventës Arhuse. Njëkohësisht PROAKTIVA përmes këtij projekti obligohet drejt përgatitjes të analizave të gjendjes aktuale (pjesëmarrjes në opinion, përgatitjes dhe zbatimit) të politikave dhe strategjive për energji dhe klimë në Rajonin statistikor të Shkupit.

Një nga detyrat e punës së këtij projekti përfshinte edhe deklarin zyrtar të PROAKTIVA-s lidhur me gjendjen aktuale dhe proceset e përgatitjes dhe zbatimit të dokumentave lokale të fokusuar në efikasitetin energjistik dhe burimet ripërtëritëse të energjisë. Prej këtu ky dokument e paraqet pozicionin e PROAKTIVA-s lidhur me politikën e efikasitetit energjistik dhe burimeve ripërtëritëse të energjisë që momentalisht e kanë institucionet kombëtare dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale (NJVL)

Metodologjia e cila përdoret për përgatitjen e këtij dokumenti përfshinte: a) parashikim dhe analizë të dokumentave ekzistuese për energjinë dhe klimën; b) parashtrimin e kërkesës për qasje në informacione për efikasitetin energjistik në NJVL; c) takime individuale me Agjencinë e Energjistikës dhe NJVL-të në Rajonin statistikor të Shkupit; d) vlerësimin e kapaciteteve të NJVL-së për përgatitjen dhe zbatimin e programeve dhe planeve aksionale për efikasitet energjistik; e) identifikimin e sfidave të përbashkëta me të cilat ballafaqohen komunat; f) njohjen e praktikave të mira të cilat janë replikabile dhe mund të shërbejnë si masa model për zbatim nga ana e NJVL-ve të tjera.

Duke pasur parasysh komponentët e cituar, përmes këtij dokumenti PROAKTIVA e përfaqëson Pozicionin e saj drejt politikave për efikasitet energjistik dhe burime ripërtëritëse të energjisë të vendit dhe komunave nga Rajoni statistikor i Shkupit. Gjatë kësaj PROAKTIVA jep edhe komplet rekomandimesh dhe i identifikon fushat kryesore në të cilat Proaktiva i vendos në dispozicion të kapaciteteve për avancimin e politikave për zbatimin e masave për efikasitet energjistik.

E shfrytëzojmë këtë mundësi që të falenderojmë të gjithë personat dhe institucionet që morën pjesë në kuadër të aktiviteteve të projektit. Para së gjithash shprehim falënderim për drejtorin e Agjencisë për energjistikë dhe personat përgjegjës për efikasitetin energjistik në kuadër të komunave të cilët në mënyrë joegoiste bënë përpjekje për transmetimin e të gjitha informacioneve të domosdoshme për përgatitjen e këtij dokumenti.

2. Hyrje

Ky dokument përpiqet që në mënyrë të qartë dhe praktike t'i paraqesë qëndrimet (pozicionet) e PROAKTIVA-s lidhur me politikat kombëtare dhe komunale lidhur me efikasitetin energjitik dhe burimet ripërtëritëse të energjisë. Gjatë kësaj fokus është vendosur në efikasitetin energjitik.

Në kuadër të dokumentit PROAKTIVA këmbëngul që të japë një pasqyrë të përgjithshme të politikave, mekanizmave të vëna, si dhe rezultatin nga proceset e planifikuara dhe zbatimin e masave për efikasitet energjitik dhe burimet ripërtëritëse të energjisë. Kjo që është e rëndësishme të përmendet në këtë kornizë është ajo që PROAKTIVA përkundër asaj që këmbëngul në kuadër të këtij kapitulli ta paraqesë pozicionin e saj, në mënyrë shtesë bën përpjeke që të japë rekomandime të qarta të cilat do të çonin drejt përforcimit të sektorit dhe afrimin e tij në rekomandimet dhe pritjet e Bashkimit Evropian.

Qëndrimet e PROAKTIVA-s i targetojnë dokumentat strategjike kombëtare dhe komunale për efikasitet energjitik dhe burime ripërtëritëse të energjisë, implementimin e tyre, inkluzivitetin dhe shkallën e qasjes së integruar gjatë përgatitjes së tyre, mekanizmin për ndjekje, revizion dhe vlerësim të dokumentave strategjike, mekanizmat interne të bashkëpunimit ndër-institucional, shkallën e sinkronizimit të politikave dhe strategjive kombëtare dhe komunale etj.

Në kuadër të fazës përgatitore që midis të tjerave përfshin intervista me përfaqësues të komunave dhe parashikimin e të gjitha informacioneve në nivel kombëtar dhe komunal për efikasitetin energjitik PROAKTIVA përpiqet që të sigurojë kushte për nxjerrjen maksimale të mësimave të mësuara dhe praktikave më të mira gjatë planifikimit dhe zbatimit të masave për efikasitet energjitik dhe përdorimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë. Shembujt e veçuar krejtësisht përkatësojnë me praktikën e identifikuar më parë të cilat në formë të rekomandimeve janë futur në kuadër të dokumentit.

PROAKTIVA mbetet e hapur për diskutim lidhur me qëndrimet dhe rekomandimet e prezantuara në dokument. Njëkohësisht dokumenti mund të përdoret lirisht nga ana e kujdo qoftë institucioni apo organizate në çfarëdo lloj qëllimesh të cilat do të kontribuonin në përforcimin e sektorit të energjitikës dhe para së gjithash në fushat e efikasitetit energjitik dhe burimeve ripërtëritëse të energjisë.

Duke pasur parasysh se dokumenti është i përgatitur në kuadër të projektit i cili midis të tjerave ka arritur që të afrojë shoqatat e qytetarëve që janë aktivë në fushën e energjisë dhe klimës, do të donim të përmendim se ky dokument është i hapur për eventalisht përdorimin e tij të mëtejshëm në drejtim të përgatitjes së Pozicionit të rrjetit të shoqatave të qytetarëve për politikat kombëtare dhe komunale për energjinë dhe klimën.

3. Politikat kombëtare për efikasitet energjistik dhe burimet ripërtëritëse të energjisë

Në këtë kapitull SHQ PROAKTIVA jep pasqyarë të shkurtër të dokumentave kryesore strategjike dhe politikave që kanë të bëjnë me efikasitetin energjistik dhe burimet ripërtëritëse të energjisë.

Politikat kombëtare për efikasitet energjistik dhe burime ripërtëritëse për energji janë të paraqitura përmes: a) planeve kombëtare aksionale për efikasitet energjistik, b) strategjisë për avancimin e efikasitetit energjistik, c) strategjisë për shfrytëzimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë; dhe d) planit aksional për burime ripërtëritëse të energjisë.

Duke i shqyrtuar dokumentat e lartpërmendur, PROAKTIVA synon drejt paraqitjes së pozicionit të saj duke dhënë rekomandime për avancimin e proceseve dhe politikave në fushën e efikasitetit energjistik dhe burimeve ripërtëritëse të energjisë.

Në përgjithësi, për tu përshëndetur janë përpjekjet e shtetit që të përgjigjet në detyrat dhe rekomandimet që vijnë nga Bashkimi Evropian. Ajo që gjithsesi mungon është qasja strategjike drejt krijimit të vizionit dhe përkrahja e saj thelbësore përmes paraqitjes së qartë të politikave strategjike, politikave kryesore dhe ndryshimeve institucionale, partneriteteve kritike, midis - mekanizmave institucionale për planifikimin dhe zbatimin, sistemin e ndjekjes dhe revizionin e dokumentave strategjikë, evolucionin e bazuar në rezultatet e marra, raportimi i rregullt i arritjeve dhe gjithsesi sistemi për inkuadrimin e sektorit privat dhe shoqatave të qytetarëve në proceset e planifikimit, vendosjen dhe zbatimin e masave për efikasitet energjistik dhe burimeve ripërtëritëse të energjisë.

Ajo që është shumë e rëndësishme është se Republika e Maqedonisë i përcakton kuotat dhe çmimet për prodhimin e energjisë nga burime ripërtëritëse (ndryshimi i fundit është në prill të vitit 2013) me çka u stimulua sektori privat që të fillojë me investime dhe zhvillim në këtë sektor.

Veçanërisht e rëndësishme është që të theksohet se sektori civil i përkrah politikat e shtetit për subvencionimin e sektorit rezidencial lidhur me përdorimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë (sistemet diellore për ujë të ngrohtë sanitar). Theksojmë se kjo qasje duhet që të zgjerohet dhe përshtatet në nevojat e qytetarëve (fasada, çati, dritare, biçikleta, ndërsa më vonë edhe biçikleta elektrike, automjete elektrike dhe hibride etj.).

Në fund do të përmendim se institucionet që janë kompetente për krijimin e politikave për efikasitet energjistik dhe burime ripërtëritëse të energjisë duhet që ta njohin rëndësinë dhe rolin e sektorit civil në kuadër të krijimit të politikave dhe zbatimin e tyre të mëtejshëm. Institucionet kombëtare duhet që t'i njohin shoqatat e qytetarëve si partnerë afatgjatë dhe tek ta të shohin nxitësin kryesor të procesit të përshtatjes së politikave sipas nevojave të qytetarëve, afrimin e politikave tek qytetarët dhe zbatimin e politikave në shkallë lokale.

3.1. Politika të përgjithshme për efikasitet energjitik dhe burime ripërtëritëse të energjisë

Dokumentat strategjikë në sferën e efikasitetit energjitik dhe burimeve ripërtëritëse të energjisë në masë të madhe përputhen me strategjinë kombëtare për zhvillim të energjitikës. Këto dokumenta gjithashtu vendosin relacione me dokumentat strategjikë të lidhur me ndryshimet klimatike. Ajo që gjithsesi mungon është lidhshmëria e qartë e këtyre dokumentave me politikat e tjera sektoriale, lidhshmëria realtivisht e dobët me strategjinë kombëtare për zhvillim afatgjatë dhe lidhshmëria thelbësore me politikat komunale për efikasitet energjitik dhe burime ripërtëritëse të energjisë.

Lidhur me të dhënat e kuantifikuara të cilat në masë të madhe i ngarkojnë dokumentat strategjikë, duhet që të theksohet se menjëherë pas vendosjes së kuotave dhe konfirmimit të çmimit të energjisë të prodhuar përmes përdorimit të burimeve ripërtëritëse të energjisë, u treguan edhe rezultate pozitive. Ndikimi i vendimit lidhur me vendosjen e çmimit të tregut në energji të prodhuar përmes përdorimit të burimeve ripërtëritëse të energjisë mund të shihet edhe përmes tabelës vijuese:

Prodhimi në MWh (stat.gov.mk)	2012	2013	2014	2015	2016	GJITHSEJ	Mesatarja
Hidrocentrale	1.036.274	1.572.384	1.195.444	1.856.016	1.869.233	7.529.351	1.505.870
Centrale elektrike solare	2.836	9.057	14.383	22.599	23.699	72.574	14.515
Centrale elektrike me erë	0	0	70.387	120.768	109.483	300.638	60.128
Centrale me biogaz	0	0	0	19.456	34.913	54.369	10.874
GJITHSEJ BRE	1.039.110	1.581.441	1.280.214	2.018.839	2.037.328	7.956.932	1.591.386
Termocentrale	4.475.712	3.742.599	3.506.444	3.092.720	2.698.976	17.516.451	3.503.290
Centrale të kombinuara dhe fuqia industriale	283.240	348.238	189.061	175.358	547.889	1.543.786	308.757
GJITHSEJ NETO	5.798.062	5.672.278	4.975.719	5.286.917	5.284.193	27.017.169	5.403.434

Tabela 1: Prodhimi i energjisë në Republikën e Maqedonisë të paraqitur në MWh¹

Tabela tregon qartë se ky hap i vendosjes së tarifave të autorizuara e sitmulon sektorin privat që të investojë në përdorimin e energjisë me erë dhe energjisë të fituar me biogaz. Këto dy komponentë vazhdojnë që të zhvillohen dhe janë fusha të interesit afatgjatë në Republikën e Maqedonisë. Këtë vit pritet prodhim i energjisë të fituar nga biogazi me vlerë të përgjithshme prej 47.800 MWh. Edhe energjia e fituar nga centralet elektrike diellore vazhdon të rritet në mënyrë të vazhdueshme dhe tek e njëjta shihet

¹ Të dhëna të marra nga Enti Shtetëror i Statistikës

një potencial i madh për zhvillim, por gjithsesi duhet që të kihet parasysh edhe nevoja e vendosjes së sistemit të ri i cili do të siguronte rritjen e kuotave për arsye se të njëjtat tashmë janë plotësuar.

Prodhimi i përgjithshëm i energjisë është konstant. Nevoja e termocentraleve bie në mënyrë të vazhdueshme. Hidrocentralet ende tregojnë vlera përafërsisht konstante, ndërsa rritja e centraleve elektrike solare dhe centraleve me biogaz është evidente.

Angazhimi dhe përkushtueshmëria e tillë e Republikës së Maqedonisë është mjaft pozitive dhe e kjo duhet që të vazhdojë në këtë drejtim.

Një hap veçanërisht përpara në promovimin dhe rritjen e përdorimit të burimeve ripërtëritëse të energjisë nga ana e amviserive paraqet vendimi për krijimin e modeleve kombëtare disavjeçare për subvencionim në përdorimin e sistemeve diellore. Kjo masë tregon rezultate të konsiderueshme dhe kjo ka nevojë për evolucion i cili do t'i paraqiste rezultatet, praktikat e mira gjithsesi leksionet e mësuara dhe gjithsesi nga ana tjetër do të paraqiste të dhëna hyrëse për krijimin e një modeli të ngjashëm për subvencionimin e masave të tjera për efikasitet energjistik dhe burime ripërtëritëse të energjisë.

Sfera në të cilën është i nevojshëm një zhvillim i konsiderueshëm është krijimi i kushteve për bashkëpunim të afërt me njësitë e vetëqeverisjes lokale. Vetëqeverisje të caktuara lokale (komuna) kanë ndërtuar kapacitete për përgatitjen e programeve progresive dhe reale për efikasitet energjistik. Nga ana tjetër ekzistojnë një numër i madh i komunave që nuk kanë në dispozicion kuadro teknike dhe nuk janë të njohura me praktikat për zbatimin e masave për efikasitet energjistik dhe burime ripërtëritëse të energjisë. Institucionet kombëtare duhet që të identifikojnë lider-komunat në këtë fushë, që t'i njohin nevojat e komunave të cilat nuk kanë kapacitet, që të nxitin procesin e bashkëpunimit ndërkomunal dhe të investojnë në stimulimin e aktiviteteve të planifikuara dhe të zbatuara të cilat do të rezultojnë me rritjen e përdorimit të masave të EE-së dhe BRE-së, respektivisht përf forcimin e kushteve për afrimin e Republikës së Maqedonisë drejt arritjes së zhvillimit afatgjatë.

Sinkronizimi i programeve është gjithsesi fushë e cila kërkon vëmendje të veçantë. Kryesisht, të gjitha komunat i përgatisin programet e tyre dhe planet aksionale në mënyrë të pavarur nga qendrat rajonale statistikore. Gjithashtu, komunat e territorit të Qytetit të Shkupit i bëjnë programet e tyre në mënyrë të pavarur nga komunat e tjera dhe në mënyrë të pavarur nga programi i Qytetit të Shkupit. Përkatësisht, edhe Qyteti i Shkupit i përgatit programet e veta për efikasitet energjistik në mënyrë të pavarur nga komunat të cilave i përkasin. Që këtu del pamundësia që të jepet maksimumi nga përpjekjet që janë bërë nga ana e komunave.

Themelimi i **ESKO** kompanive dhe formimi i Fondit për efikasitet energjistik janë temat në të cilat duhet të bëhen përpjekje maksimale për sigurimin e kushteve që do të rezultojnë me vendosjen e praktikave dhe modeleve thjesht të përdorueshme të cilat do të japin rezultate.

Pozita e PROAKTIVA-s lidhur me politikat e përgjithshme kombëtare për efikasitet energjitik dhe burime ripërtëritëse të energjisë është si më poshtë:

- Po 1.1 Në Republikën e Maqedonisë **nuk ekziston bazë e të dhënave për objektet që janë nën kompetenca të institucioneve lokale apo kombëtare.** Që këtu janë edhe pengesat për ekzistimin e shqyrtimit të hollësishëm të konsumit të përgjithshëm energjitik dhe kërkesa e përgjithshme e energjensëve. Kjo mangësi e të dhënave njëkohësisht të çon drejt pamundësisë për përcaktimin e saktë të kursimeve, planit financiar dhe gjithësi marrjes së të dhënave për ndikimin ndaj mjedisit të jetesës.
- Po 1.2 **Nuk ekziston mekanizëm sipas të cilit janë sinkronizuar dokumentat strategjike dhe politikat kombëtare, rajonale dhe lokale** për efikasitet energjitik dhe burime ripërtëritëse të energjisë.
- Po 1.3 **Deri tani nuk ekziston asnjë rast i evidentuar në të cilin ekziston gjobë/sanskion për komunën e cila nuk ka përgatitur program komunal për efikasitet energjitik.** Kjo lloj praktike është e palejueshme dhe i stimulon komunat që të mos i plotësojnë detyrimet e tyre ligjore. Gjithashtu krijon revolt tek komunat që bëjnë përpjekje për plotësimin e detyrimeve të tyre. Para së gjithash, kjo qasje i stimulon këto komuna të cilat nuk kanë përgatitur programe që të vazhdojnë me të njëjtën praktikë, ndërsa me këtë edhe të mos avancojnë në fushën e efikasitetit energjitik dhe shfrytëzimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë.
- Po 1.4 **Fondi për efikasitet energjitik i cili për një periudhë të gjatë paralajmërohet nuk po bëhet realitet.** Edhe pse në këtë çështje diskutohet tashmë një dekadë, themelimi i fondit nuk po realizohet. Pamundësia që të zhvillohet një model aplikativ në masë të madhe e anulon themelimin e fondit, ndërsa me këtë ulet edhe intensiteti i përdorimit të masave dhe me këtë ngadalësohet edhe zhvillimi i vendit.
- Po 1.5 Republika e Maqedonisë tregon **rezultate të këqia** lidhur me efikasitetin energjitik në proceset e **prodhimit, përçimit, distributimit dhe përdorimit të energjisë.**
- Po 1.6 **Përdorimi i resurseve të disponueshëm** (potenciali hidroenergjitik, energjia me erë, energjia diellore, gazi natyror) **për prodhimin e energjisë elektrike edhe më tej është i pamjaftueshëm.**
- Po 1.7 **Procesi i integritetit të sektorit energjitik të Republikës së Maqedonisë me tregun rajonal dhe evropian të energjisë elektrike është i ngadalshëm dhe nuk përputhet me rekomandimet**
- Po 1.8 **Subvencionet për përdorimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë u treguan si shumë të dobishme** dhe të praktikuara nga ana e qytetarëve.
- Po 1.9 **Nuk ka përparim në sigurimin e modelit të ri dhe kuotave për prodhuesit e autorizuar të energjisë elektrike të fituar nga dielli.**

Po 1.10 **Proceset e planifikimit të hidrocentraleve tregojnë mangësi në cilësi, transparencë dhe dëshirë për diskutim i cili do të çonte drejt përzgjedhjes së zgjidhjes më të mirë.** Kryesisht proceset për planifikim e përjashtojnë dialogun e hapur me shoqatat e qytetarëve si në sferën e efikasitetit energjistik, ashtu edhe në sferën e mbrojtjes së natyrës. Transparenca e proceseve tërësisht është lënë pas dore kështu që Ministria e Ekonomisë mbështetet vetëm në kapacitetet e saj interne dhe kapacitetet e ekipit i cili i përpilon projektet. Shembulli me stopimin e procesit në ndërtimin e hidrocentraleve në kuadër të Parkut Kombëtar të Mavrovës është një shembull klasik për planifikim të paqëndrueshëm, përjashtimin e sektorit civil, jo transparencë dhe dëshirë që të zbatohet aktivitet në çdo lloj mënyre. Kjo qasje nuk dha rezultate, procesi u ndërpre, shumë kohë dhe para u shpenzuan kot, ndërsa institucionet shtetërore ende zhvillojnë kontest me gjykatat evropiane në pajtueshmëri të mosrespektimit të kartave internacionale të ratifikuara nga shteti.

Rekomandime:

Re 1.1 Nevojitet formimi urgjent i bazës të së dhënave për objektet që janë nën kompetencë të institucioneve lokale apo kombëtare. Gjithashtu rekomandohet analizë e të dhënave me qëllim që të identifikohen të dhënat historike të konsumit energjistik dhe nevojat momentale të energjisë. Në fund, nevojitet përgatitje e kornizës reale financiare, përcaktimi i kursimeve të pritura dhe gjithësesi integrimi i rezultateve nga perspektiva e ndikimit ndaj mjedisit të jetesës, para së gjithash uljen e emisionit të gazrave të qelqta.

Re 1.2 Ministria e Ekonomisë, ndërsa para së gjithash Agjencia e Energjistikës duhet të përgatisë dhe të promovojë mekanizëm sipas të cilit do të synohet drejt sinkronizimit të plotë të politikave dhe masave kombëtare, rajonale dhe lokale për efikasitet energjistik dhe burime ripërtëritëse të energjisë. E palejueshme është, për shembull, proceset e përgatitjes së programeve për efikasitet energjistik të Qytetit të Shkupit dhe komunave në rajonin e tij të kenë procese të izoluara dhe të pavarura të planifikimit dhe zbatimit të masave për EE dhe BRE.

Re 1.3 Nevojitet që Agjencia e Energjistikës të bëjë përpjekje për sigurimin e kushteve në të cilat komunat do të arrijnë në kohë t'i parashtojnë programet komunale trevjeçare dhe planet aksionale vjetore për efikasitet energjistik. Identifikimi i praktikave më të mira të cilat janë replikabile në mbarë vendin të pasqyruara në formën e kursimeve financiare do të ndihmonin në fitimin e interesit për masat. Përforcimi i kapaciteteve për qeverisje teknike të temës është i domosdoshëm. Trajnim për kryerjen e proceseve për përgatitjen e programeve trevjeçare dhe planeve aksionale për efikasitet energjistik do të duhet të ishte masa vijuese në pikpamje të përforcimit të kapaciteteve komunale. Qasje të vazhdueshme për debatet bilaterale me komunat është më tepër se e rekomanduar. E njëjta do të duhet të mbulojë të gjitha çështjet e hapura, paqartësitë dhe pengesat në zbatimin e proceseve të përgatitjes të dokumentave strategjike komunale për efikasitet energjistik dhe burime

ripërtëritëse të energjisë. Me qëllim që në një masë të madhe të lehtësohet axhenda e Agjencisë, nevojitet investim në bashkëpunimin ndërkomunal i cili do të ishte i orientuar në sigurimin e rezultateve të pritura. Ky bashkëpunim jo vetëm që do të synonte drejt përfundimit të kapaciteteve të komunës e cila nuk ka në dispozicion kuadro të mjaftueshme në sferën e efikasitetit energjitik, por i njëjti në një masë të madhe do të çonte drejt krijimit të komunikimit të vazhdueshëm dhe krijimit të partneritetit strategjik.

Re 1.4 Fondi për efikasitet energjitik është masë e cila hasi në kritika pozitive nga të gjitha palët e prekura. Sektori privat dhe civil në tërësi e përkrahën idenë për formimin e fondit i cili do ta lëvizte zhvillimin e efikasitetit energjitik në vend. Të bëra nga tashmë analiza të zhvilluara dhe modelet për formimin e fondit, Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia e Energjitikës do të duhet që të sigurojë debate të hapura me të gjitha palët e interesuara. I rekomanduar është formimi i forumit në të cilin do të merrnin pjesë institucionet kombëtare dhe lokale, shoqata të qytetarëve dhe pjesëtarë të sektorit privat. Bartësit e idesë duhet që të sigurojnë kushte në të cilat në mënyrë krejtësisht produktive do të diskutohen të gjitha opsionet, pengesat dhe përparësitë e modeleve të ndryshme që në fund të gjendet një zgjidhje e përbashkët për mekanizmin më pragmatik i cili do të mund të zbatohet pa pengesa në praktikë.

Re 1.5 Republika e Maqedonisë do të duhet që të investojë përpjekje për përfundimin e efikasitetit energjitik në proceset e prodhimit, përcimit, distribuimit dhe përdorimit të energjisë. Varësia intensive e importit të energjisë elektrike nuk lejon hapësirë për dilema nëse duhet dhe sa duhet që të investohet në proceset e rritjes së prodhimit. Nga ana tjetër duhet që të krijohen kushte për përdorimin efektiv të energjisë disponuese. Përcimi dhe distribuimi i energjisë duhet që të përmirësohet duke u nisur nga fakti se pikërisht në këtë fushë kemi humbje të mëdha. Në fund është më se e qartë se prodhimi duhet që të fokusohet drejt rritjes së konsiderueshme të përdorimit të burimeve ripërtëritëse të energjisë ndërsa përdorimi i energjisë duhet të synojë që të zbatohet përmes përdorimit të masave efektive energjitike.

Re 1.6 Analiza të veçanta gjithëpërfshirëse për të gjitha burimet e veçanta ripërtëritëse të energjisë janë të domosdoshme për marrjen e të dhënave të hollësishme të cilat do t'i japin drejtimet drejt të cilave duhet që të ndërtohet vizioni dhe qëllimet e vendit lidhur me shfrytëzimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë. Nevojitet krijimi i partneriteteve strategjike me agjensi donatore dhe orgnizata internacionale të cilat çojnë drejt sinkronizimit të përcaktimeve dhe programeve strategjike. Kjo nga ana tjetër nënkupton obligim dhe angazhim të veçantë për përkrahje gjatë procesit të zbatimit. Nevojitet vendosja e masave përkatëse stimuluese. Targetimi dhe inkuadrimi i qartë i sektorit civil dhe privat janë të domosdoshme. Mekanizmat ndërinstucionale duhet që të jenë të përkufizuara qartë, para së gjithash në drejtim të detyrimeve dhe sinkronizimit të politikave të sektorëve të veçantë.

- Re 1.7 Edhe përkundër implikimeve të qarta afatshkurtra nga aspekti social dhe ekonomik, nuk duhet që t'i japim arsyetim të veçantë asaj që Republika e Maqedonisë duhet që të përshejtojë në procesin e liberalizimit dhe integritit të sektorit energjistik me tregun rajonal dhe evropian të energjisë elektrike dhe saktësimin të tregut me gazin natyror.
- Re 1.8 Nevojitet program afatgjatë për vendosjen e serisë të masave progresive për subvencionimin e efikasitetit energjistik dhe përdorimit të burimeve ripërtëritëse të energjisë në amviseri. Programi duhet që të jetë parkatik dhe t'i pasqyrojë nevojat e qytetarëve. I njëjti duhet që të prekë si informacion tek të gjithë qytetarët dhe të përkrahët me shembuj konkretë të kuantifikuar në raport të investimit, tarifës financiare, mjeteve financiare të kursyera në shkallë vjetore dhe periudhën e pagesës. Institucionet kombëtare, komunat, shoqatat e qytetarëve, sektori privat dhe mediat duhet që të përfshihen në mënyrë përkatëse. Gjatë kësaj nevojitet që të gjitha palët e interesuara të funksionojnë si një ekip në të cilin mekanizmi i bashkëpunimit është përkufizuar qartë, ndërsa detyrimet dhe aktivitetet plotësohen si në shkallë lokale ashtu edhe në atë kombëtare.
- Re 1.9 Nevojitet përparim në sigurimin e modelit të ri dhe kutoave për prodhues të autorizuar të energjisë elektrike të fituar nga dielli.
- Re 1.10 Hidrocentralet janë të njohura si fokusi i shtetit lidhur me uljen e varësisë nga importi i energjisë dhe njëkohësisht si kontribut drejt pjesëmarrjes së burimeve ripërtëritëse të energjisë në prodhimin e përgjithshëm të energjisë elektrike. Në mënyrë plotësuese, hidrocentralet janë të njohura si komponenti kryesor strategjik për mbulimin e kulmeve energjitike lidhur me kërkesën e energjisë elektrike. Që këtu është e qartë se bëhet fjalë për një element të rëndësishëm kritik dhe strategjik. Duke pasur parasysh këtë, duhet të jetë e qartë se qasja drejt kësaj çështjeje duhet që të ketë rëndësinë e saj përkatëse. Transparenca, inkluziviteti në procesin e planifikimit, integrimi i sferës sociale, ekonomike dhe mjedisit të jetesës, veçanërisht inkadrimi thelbësor i shoqatave të qytetarëve dhe organizatave internacionale me portfolio në sferën e mbrojtjes së natyrës. Qasja në çfarëdo lloj rasti duhet të jetë në gjetjen e modeleve që do të realizojnë idenë për fitimin e hidroenergjisë së nevojshme, por njëkohësisht do të jenë të kujdesshëm kundrejt mjedisit të jetesës, veçanërisht drejt llojeve të cilat njihen si të rrezikuara dhe ekosistemet që kanë rëndësi të veçantë për trashëgimninë natyrore të Republikës së Maqedonisë. Dialogu i hapur, qasja pragmatike drejt të gjitha çështjeve dhe pikësnyimi që të njihen të gjitha sfidat do të çonte drejt identifikimit të opsioneve më të mira që janë në dispozicion dhe të cilat ofrojnë zgjidhje për tejkalimin e pozicioneve eventuale të konfliktit para së gjithash me konventat të cilat janë të orientuara për mbrojtjen e natyrës.


3.2. Plani i parë aksional për efikasitet energjitik i Republikës së Maqedonisë deri në vitin 2018



Plani i parë aksional për efikasitet energjitik u përgatit në vitin 2011. Pikërisht ky dokument paraqet element kryesor për të cilin Republika e Maqedonisë atë vit mori koment pozitiv në pjesën e efikasitetit energjitik në kuadër të kapitullit 15 (Energjia) nga raporti vjetor i Komsionit Evropian.


Për tu përsëritur është edhe përpjekja që u bë në kuadër të përgatitjes së këtij dokumenti drejt ndjekjes së angazhimeve dhe rekomandimeve që dalin nga Grupi i punës për efikasitet energjitik të Komunitetit Energjitik nga Vjena (Energy Community).

Qëndrimi (pozita) i PROAKTIVA-s lidhur me Planin e parë aksional për efikasitet energjitik deri në vitin 2018 është se :



Po 2.1 **Plani është në pajtim me rekomandimet e Komunitetit Energjitik.** Dokumenti është mjaft i hollësishëm dhe bazohet përafërsisht në modelimin real ekonomik dhe energjitik, ndërsa rekomandimet që dalin nga plani në masë të madhe përputhen me nevojat reale të sektorit energjitik në Republikën e Maqedonisë

Po 2.2 **Procesi i përpilimit të këtij dokumenti nuk siguroi inkuadrim thelbësor të sektorit civil.** Gjithashtu, përmendim se në kuadër të këtij dokumenti sektori civil është përmendur vetëm një herë dhe kjo në pjesën e zbatimit të fushatave informative.



Po 2.3 **Plani nuk është në pajtim me direktivën 2006/32/SE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për efikasitet tek konsumi përfundimtar i energjisë dhe për shërbimet energjitike (DEKPEEU-E).** Kjo direktivë kërkon nga vendet-anëtare që të përpilojnë tre Plane aksionale kombëtare për efikasitet energjitik për periudhën 2008-2016. Jo vetëm që Planin e parë kombëtar për efikasitet energjitik Republika e Maqedonisë e parashtroi me **vonesë prej tre vitesh**, por vetë plani sipas periudhës të mbulimit të qëndrimeve bëri të qartë se Republika e

Maqedonisë **nuk parashikon që t'i ndjekë drejtimit e direktivës për përgatitjen e tre Planeve aksionale kombëtare në periudhën 2008-2016.**

Duhet të përmendet edhe fakti se vetë direktiva e përmend vitin e fundit nga cikli i parë i mbulimit (vitin 2016) ndërsa **Republika e Maqedonisë me këtë plan e kalon periudhën e përcaktuar të mbulimit** duke cituar vitin 2018 si vitin përfundimtar të përfshirë nga ky plan.

Si shembull e citojmë informacionin se numri më i madh i vendeve anëtare Planin e parë aksional për efikasitet energjistik e kishin parashtruar në Komsionin Evropian në gjysmën e parë të vitit 2007 duke i treguar kapacitetet e tyre, interesin dhe rëndësinë e kësaj teme në kuadër të përpjekjeve të tyre drejt arritjes së qëndrueshmërisë në shkallë kombëtare.

- Po 2.4 Plani i dytë aksional për efikasitet 2013-2015 e shqyrtoi parashikimin e bërë me planin e parë dhe që këtu pason edhe kritika jonë pozitive për hapin përpara drejt afrimit të rekomandimeve të direktivave 2006/32/ES. Edhe pse përafërsisht në mënyrë konfuze krijohen kushte për përgatitjen e planeve trevjeçare aksionale për efikasitet energjistik. Megjithatë duhet që të kihet parasysh se me vetë këtë **krijohen kushte për harmonizimin e mundshëm të planeve kombëtare dhe programeve trevjeçare komunale për efikasitet energjistik.**
- Po 2.5 **Planet aksionale kombëtare për efikasitet energjistik nuk janë pasuar me raportime vjetore** lidhur me zbatimin e tyre dhe azhurimin eventual. Shqetësues është indikatorin se jo vetëm që planet në vetëvete nuk përmbajnë metodologji për të cilën do të bëhen raportime vjetore lidhur me zbatimin e planeve, por edhe vetë raportimi në përgjithësi nuk ekziston në kuadër të planeve dhe i njëjti nuk është parashikuar në asnjë lloj baze.
- Po 2.6 **Plani kombëtar për efikasitet energjistik nuk parashikon shqyrtim afatmesëm, revizion dhe përshtatje.** Kryesisht, çdo dokument strategjik kombëtar me periudhë të vlefshmërisë prej 9 vitesh në vetvete duhet që të parashikojë shqyrtim afatmesëm me qëllim që të vërehet zhvillimi dhe zbatimi i planit, të ballafaqohen sfidat, të identifikohen gjendjet e reja të krijuara të cilat ndikojnë në zbatimin e planit dhe në pajtimin e tyre të bëhet revizion i dokumentit me çka i njëjti do të përshtatet në kushtet e reja dhe me këtë do të ketë kushte më të mira për implementimin e tij në kushte reale të ambientit.
- Po 2.7 Plani aksional kombëtar për efikasitet energjistik parashikon investime prej 406 milionë eurosh për periudhën prej vitit 2011-2018. Gjatë kësaj parashikohet sigurimi i financave prej mbi 82 milionë eurosh nga buxheti i Republikës së Maqedonisë prej mbi 82 milionë eurosh nga buxheti i Republikës së Maqedonisë. Bëhet fjalë për shifra serioze që jo vetëm duhet të sigurohen nga burime të jashtme, por njëkohësisht edhe të ponderojnë buxhetin shtetëror, ndërsa **Plani aspak nuk flet për mënyrën në të cilën**

mund të sinkronizohen proceset e planifikimit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Gjithashtu, **nuk është përkufizuar as mekanizmi i sinkronizimit me ministrinë dikasteriale të Shëndetësisë dhe të Arsimit** në të cilat priten investimet më të mëdha (spitale-shkolla).

Rekomandime:

Re 2.1 Nevojitet të vendoset praktikë e vazhdueshme në inkuadrimin e sektorit civil në përgatitjen e dokumentave me interes kombëtar. Veçanërisht nevojitet inkuadrimi i shoqatave të qytetarëve në pjesën e planifikimit dhe zbatimit të masave në shkallë kombëtare dhe lokale.

Në këtë mënyrë shoqatat e qytetarëve ndejnë pronësi mbi dokumentat kombëtare, ndërsa me vetë këtë edhe detyrim për zbatimin e të njëjtave. Duke ndjerë detyrime për zbatimin e planeve kombëtare dhe lokale për efikasitet energjitik, shoqatat e qytetarëve në partneritet me institucionet në shkallë lokale dhe kombëtare do të mund të siguronin edhe mjete financiare për zbatimin e masave të parashikuara me planet aksione, duke pasur parasysh qasjen e tyre në grante të parashikuara me planet e donatorëve dhe organizatave internacionale të pranishme në Republikën e Maqedonisë me portfolio përkatëse.

Gjithsesi jo më pak i rëndësishëm është fakti se me inkuadrimin e sektorit civil në kuadër të dialogut dhe procesve të planifikuara dhe zbatimin e planeve aksionale kombëtare dhe lokale, në mënyrë direkte përforcohet edhe kapaciteti i shoqatave të qytetarëve. Që këtu, qasja e tillë njëkohësisht rezulton edhe me përforcimin e kapaciteteve të shoqatave të qytetarëve prej të cilave pritet zbatimi i masave të caktuara të parashikuara me planet.

Nevojitet një ndjekje më e zhdërvjellë e rekomandimeve nga Bashkimi Evropian dhe analizimin e tyre të hollësishëm me qëllim që nga njëra anë të njëjtat të implementohen në mënyrën përkatëse ndërsa nga ana tjetër në mënyrë përkatëse të përshtaten edhe qëndrimet në kontekst të nevojave reale të Republikës së Maqedonisë.

Gjithsesi, ajo që është mjaft e rëndësishme është që në të ardhmen të vendoset një mekanizëm përkatës kombëtar për mobilizimin e shpejtë të kuadrit ndër-sektorial i cili do të ishte në gjendje për përgjigje në kohë të kërkesave nga Bashkimi Evropian.

Re 2.2 Republika e Maqedonisë duhet që të këmbëngulë që çdo dokument me karakter të tillë të vijojë me raporte vjetore. Një qasje e tillë mundëson transparencë, por edhe mundësi që të gjitha palët e interesuara të njihen me aktivitetet e zbatuara, rezultatet e marra, sfidat e reja, nevojat dhe mundsitë e reja që do të mund të përdoren për zbatimin e planit. Në këtë mënyrë të gjitha palët e interesuara do të mundeshin në kohë të inkuadroheshin në kuadër të programeve të tyre dhe në këtë mënyrë ta përkrahin/ndihmojnë

procesin e zbatimit në (këtë rast) Planit aksional kombëtar për efikasitet energjistik.

Re 2.3 Plani kombëtar për efikasitet energjistik dhe të gjitha planet afatgjatë dhe afatmesme kombëtare dhe lokale të kësaj natyre do të duhet të inkuadrojnë një shqyrtim periodik strategjik dhe teknik dhe revizion të mundshëm dhe/ose adaptim.

Në këtë mënyrë sigurohet azhurimi i të dhënave, adaptimi i rrethanave të reja të mundshme, ndryshimi i prioriteteve dhe aktiviteteve në pajtim me prioritetet e vendit dhe/ose Bashkimit Evropian, zhvendosja kohore e masave dhe aktiviteteve të caktuara si rezultat i zbatimit të tyre të parakohshme ose të vonuar dhe gjithësi përshtatja e planit të tërësishëm me çka i njëjti do të kishte perspektivë reale dhe me këtë edhe kushte të siguruara për zbatimin e tij pa pengesë.

Re 2.4 Nevojitet koordinim i përforcuar ndërrikasterial dhe sinkronizim i planeve të institucionve të ndryshme shtetërore. Është shumë e rëndësishme që të sigurohet mekanizëm përmes të cilit veçanërisht ministria e Financave, Arsimit, Shëndetësisë dhe Punës dhe Politikës Sociale përmes bashkëpunimit të ngushtë me Ministrinë e Ekonomisë dhe Agjencinë e Energjistikës do t'i përfshinin masat e parashikuara me planet kombëtare për efikasitet energjistik dhe burime ripërtëritëse të energjisë.

3.3. Strategjia për avancimin e efikasitetit energjitik në Republikën e Maqedonisë deri në vitin 2020



Qëllimi i dokumentit është që ta paraqesë qasjen strategjike të Republikës së Maqedonisë lidhur me sigurimin e furnizimit të sigurt dhe cilësor me energji tek konsumatorët.

Konstatimi është se strategjia bën përpjekje për lidhjen e efikasitetit energjitik me zhvillimin ekonomik, zhvillimin social dhe mbrojtjen e mjedisit të jetesës. Njëkohësisht, ky dokument në masë të madhe fokusohet në relacionin me dokumentat e tjerë strategjikë.

Për të përshëndetur është edhe tentativa për inkuadrimit në sferën e varfërisë energjitike të shoqëruar me një sërë masash sociale.

Me rëndësi të veçantë është edhe fokusimi i përforuar i sektorëve të identifikuar me

potencial të madh për zhvillim si dhe paralajmërimi për liberalizimin e tregut dhe themelimin e fondit për efikasitet energjitik.

Strategjia jep rekomandim të qartë për ndarjen e përgjegjësisive midis Agjencisë të Energjitikës dhe Ministrisë së Ekonomisë lidhur me zbatimin dhe ndjekjen.

Ajo që na gëzon veçanërisht janë sferat e njohura në të cilat i jepet hapësirë sektorit civil për nxitjen e procesit në zbatimin e strategjisë.

Pozita e PROAKTIVA-s lidhur me Strategjinë për avancimin e efikasitetit energjitik deri në vitin 2020 është se:

Po 3.1 Edhe kjo **Strategji këmbëngul që ta ndërmarrë rolin e programit detajor.**

Dokumenti **pikësynon në hedhjen e të gjitha informacioneve të mundshme duke krijuar prej tij një material të fuqishëm i cili e merr rolin e programit dhe planit aksional.**

Po 3.2 **Dokumenti nuk fokusohet në partneritete strategjike** dhe inkuadrimit pragmatik të agjencive donatore dhe organizatave internacionale.

Po 3.3 Strategjia **nuk jep pasqyrë të qartë të linjave të nevojshme për kordinim horizontalisht edhe vertikalisht.**

Po 3.4 Strategjia **nuk jep shqyrtim dhe rekomandime për vendosjen e masave inovative dhe as nuk bën prezantimin e praktikave të mira replikabile.**

Po 3.5 Strategjia **nuk e njeh sektorin civil si trup i cili do të duhet që të inkuadrohet në proceset e planifikuara.**

Në thelb, edhe kjo strategji sillet si program i hollësishëm pa e llogaritur kështu rolin e strategjisë së duhur e cila është e fokusuar në çështje strategjike por merret me informacione teknike, të dhëna statistikore dhe analiza.

Rekomandime

Re 3.1 Strategjia **duhet që të fokusohet në çështje strategjike**, ndërsa me këtë edhe të japë një pasqyrë të hollësishme të qasjes strategjike të vendit lidhur me **politikat thelbësore, politikat kryesore dhe ndryshimet institucionale, partneritetet kritike** etj.

Re 3.2 Strategjia **duhet që t'i shmangë analizat e hollësishme, statistikat dhe informacionet teknike** të cilat e ngarkojnë dokumentin që duhet të shërbejë edhe për sektorët e tjerë, të cilët nuk kanë nevojë për detaje për t'i përfshirë politikat e paraqitura për efikasitet energjitik në kuadër të politikave të tyre sektoriale. Këtë duhet t'ia lërë programeve të cilat në vetvete i tërheqin planet aksionale për realizimin dhe ndjekjen e mëtejshme të së cilave janë të nevojshme analiza detajore dhe ngarkimi i tyre me të dhëna teknike.

Re 3.3 Strategjia **duhet që të gjejë mënyrë që t'i paraqesë partneritetet kryesore të cilat do të çonin drejt realizimit të vizionit të Republikës së Maqedonisë** lidhur me avancimin e efikasitetit energjitik. Duke përmendur vizionin, duhet që të citohet edhe fakti se **kjo strategji aspak nuk e jep vizionin e Republikës së Maqedonisë për avancimin e efikasitetit energjitik**, ndërsa i njëjti është pjesa më e rëndësishme e çdo strategjie, duke përfaqësuar qëndrimin dhe synimin e shtetit drejt çfarëdo lloj çështjeje.

Partneritetet kryesore janë shumë të rëndësishme nga disa perspektiva. Një prej tyre është gjithsesi zbatimi i ardhshëm i strategjisë. Duke pasur parasysh gjendjen ekonomike në vend pritet që zbatimi i përcaktimeve strategjike për avancimin e efikasitetit energjitik në masë të madhe do të varet nga përfshirja e agjencive donatore dhe organizatave internacionale të pranishme në vend me portfolio përkatëse. Edhe plani i parë kombëtar për efikasitet energjitik citon qartë se Republika e Maqedonisë pret që të përfshihet me vetëm rreth 20% (82 milionë euro) nga investimi i përgjithshëm (406 milionë euro) të parashikuara me vetë planin.

Për realizimin e një plani të tillë është e nevojshme që komuniteti ndërkombëtar të ndjejë pronësi drejt angazhimeve të paraqitura në dokument. Për tu siguruar ndjenja e pronësisë ndaj dokumentit, komuniteti ndërkombëtar duhet të përfshihet në mënyrë thelbësore në kuadër të planifikimit të vetë dokumentit. Kjo lloj qasje jo vetëm që do të sigurojë partneritet të përforcuar por edhe do të harmonizojë strategjinë kombëtare me programet për efikasitet energjitik të agjencive donatore dhe organizatave internacionale.

Re 3.4 **Është shumë e rëndësishme që strategjia t'i arsyetojë ndryshimet thelbësore, t'i paraqesë masat inovative dhe gjithsesi t'i njohë dhe validojë praktikat më të mira të zbatuara në vend,** para së gjithash ato që janë replikabile në numrin më të madh të komunave.

Re 3.5 Nevojitet një ndryshim thelbësor në mendimin lidhur me rolin e sektorit civil në sferën e efikasitetit energjitik. Domethënë, bartësit e vendimeve duhet që të ndryshojnë proceset e tyre standarde të përgatitjes së dokumentave strategjike në fushën e efikasitetit energjitik duke filluar me atë që shoqatat e qytetarëve duhet të përfshihen në mënyrë thelbësore në proceset e planifikimit, ndërsa gjatë kësaj duhet që të krijohet mekanizëm i cili do të sigurojë marrjen e mendimit nga sektori civil para marrjes së vendimeve.

3.4. Strategjia kombëtare për shfrytëzimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë deri në vitin 2020



Përgatitja e strategjisë u zbatua nën udhëheqje të Akademisë të Shkencave dhe Artit të Maqedonisë, ndërsa nën mbikëqyrje të Ministrisë së Ekonomisë.

Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është që të marrin informacione kuantitative për potencialin dhe eksplotimin e mundshëm të burimeve ripërtëritëse të energjisë në Republikën e Maqedonisë.

Veçanërisht gëzon fakti që në periudhën kur shteti filloi me krijimin e dokumentave strategjikë (afatgjatë) në fushën e energjitikës, rëndësi të veçantë iu dha burimeve ripërtëritëse të energjisë.



Jo vetëm që u inkuadrua drejt përgatitjes së strategjisë për shfrytëzimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë, por shteti përgatiti edhe plan përkatës aksional për burime ripërtëritëse të energjisë.

Edhe kjo strategji e ndjek tashmë qasjen e standardizuar të përgatitjes së dokumentit që në vetvete përfshin një seri analizash dhe statistikash.

Pozicioni i PROAKTIVA-s në raport me Strategjinë për avancimin e efikasitetit energjitik deri në vitin 2020 është se:

As kjo strategji nuk jep vizionin e vendit lidhur me sferën që përpilohet në kuadër të dokumentit. Jo vetëm që vizioni nuk është

paraqitur por strategjia vjen deri në atë shkallë të hollësive që jep të dhëna edhe për të gjitha hidrocentralet të cilat janë ofruar në tender.

Po 4.1. Strategjia thotë se qëllimi i saj është që të prodhojë informacione të kuantifikuara për potencialin dhe eksplotimin e mundshëm të burimeve ripërtëritëse të energjisë në Republikën e Maqedonisë. **Strategjia është sjellë në nivel të analizës ose planit aksional**, dhe që këtu nuk mund të krahasohet me strategji. Strategjia aspak nuk duhet që të merret me krijimin

e analizave dhe gjenerimit të informacioneve teknike të kuantifikuara (Shiko Re 2.1. Re 2.3 dhe Re 2.4)

Po 4.2. **Strategjia dhe plani aksional për burime ripërtëritëse të energjisë janë jo të sinkronizuara me kohën.** Domethënë, është e palejueshme që strategjia për shfrytëzimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë të përfshijë periudhën 2010-2020 ndërsa plani aksional për burime ripërtëritëse të përfshijë periudhën 2015-2025/2030).

Po 4.3. Në këtë strategji, **shoqatat e qytetarëve mbeten tërësisht të lëna pas dore dhe të njëjtat nuk përmenden aspak.** Pjesëmarrja e shoqatave të qytetarëve nuk është e theksuar në asnjë nga sferat as në çfarëdo lloj procesi, ndërsa kjo është gjithësi e palejueshme edhe në të ardhmen do të duhet që të jetë fushë në të cilën duhet të diskutohet shumë.

Po 4.4. **Edhe kjo strategji nuk i tangon partneritetet strategjike.** Agjencitë donatore dhe organizatat internacionale nuk janë thelbësisht të integruara në procesin e krijimit të dokumentit. Të njëjtat nuk e ndejnë strategjinë si dokument i cili përputhet me programet e tyre. Sinkronizimi mungon, ndërsa me këtë edhe zbatimi i ardhshëm i strategjisë.

Po 4.5. **Strategjia aspak nuk flet për mekanizmin e ndjekjes së zbatimit, vlerësimin** e mundshëm periodik dhe as për **ndarje të rreptë institucionale të përgjegjësave** lidhur me ndjekjen e zbatimit të strategjisë.

Për fat të keq edhe në këtë rast konstatojmë se kjo strategji është si program i hollësishëm duke mos e marrë rolin e strategjisë të duhur që është e fokusuar në çështjet strategjike, por ngarkohet me informacione teknike, të dhëna statistikore dhe analiza.

Rekomandime:

Re 4.1 Çdo **strategji vijuese duhet që të fokusohet në vizionin** e Republikës së Maqedonisë, **mekanizmin e saj të arritjes, parnteritet e nevojshme strartegjike** që të çojnë drejt zbatimit real dhe në kohë të programeve/masave, definimit të rreptë institucional të **shpërndarjes së përgjegjësave**, një set qartë i paraqitur **i ndryshimeve të nevojshme strategjike, identifikimin e praktikave më të mira** dhe theksimin e tyre si fushë e replikimit të ardhshëm dhe gjithësi promovimin e ideve inovative dhe procesve që do të përforconin përdorimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë.

Re 4.2 Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia e Energjetikës duhet që të krijojë mekanizëm proaktiv i cili do të mundësojë **inkuadrimin thelbësor të shoqatës së qytetarëve në procesin e planifikimit dhe zbatimit** të politikave dhe masave për përdorimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë. Nëse ka nevojë, me kërkesë të Ministrisë së Ekonomisë, mekanizmi duhet që të jetë i përgatitur edhe nga ana e shoqatave qytetare që janë aktive në sferën e efikasitetit energjitik.

- Re 4.3 Strategjia për burime ripërtëritëse të energjisë si dhe programet e saj dhe/ose planet aksionale duhet që të jenë **mekanizëm i qartë për ndjekjen e zbatimit**. Gjatë kësaj është i domosdoshëm edhe inkuadrimi i evolucionit periodik **(afatmesëm) vlerësimin e** përparimit (masat e zbatuara), **adaptimi i mundshëm apo revizioni** dhe prezantimi i qartë i ndryshimeve.
- Re 4.4 Strategjia njëkohësisht duhet që të përfshijë edhe **raportimin** e rregullt (vjetor) të përparimit në zbatim dhe e njëjta të jetë publike dhe të ketë mundësi për komente.

4. Politika komunale për efikasitet energjetik

Ky kapitull fokusohet në paraqitjen e përgjithshme të politikave komunale për efikasitet energjetik dhe burime ripërtëritëse të energjisë. Për këtë qëllim SHQ PROAKTIVA ka realizuar një sërë takimesh me bartësit teknikë të këtij komponenti në kuadër të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (komunave) në territorin e qytetit të Shkupit.

Mund të thuhet se komunat e Shkupit dallohen në mënyrë drastike lidhur me kapacitetet të cilat i kanë në dispozicion, si nga aspekti i proceseve të planifikimit, ashtu edhe nga aspekti i zbatimit të masave për efikasitet energjetik dhe përdorimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë.

Periodha përgatitore për zbatimin e intervistave të strukturuar dhe përgatitja e këtij dokumenti, u shfrytëzuan për testimin e politikave komunale për transparencë. Qasje në informacione dhe transparencë drejt shoqatave të qytetarëve. Megjithatë duhet që të përmendet edhe ajo se janë vërejtur përmirësime lidhur me inkuadrimin i cili ishte përdorur dhjetëra vitë më parë. Numri më i madh i komunave janë më të hapura për bashkëpunim me shoqatat e qytetarëve dhe të njëjtat shikojnë mundësi që përmes partneritetit me shoqatën e qytetarëve të vijnë deri në rritjen e zbatimit të programeve komunale dhe planeve aksionale për efikasitet energjetik.

Politikat komunale për efikasitet energjetik u diskutuan nga perspektiva e: a) dokumentave strategjikë për zhvillimin e efikasitetit energjetik dhe burimeve ripërtëritëse të energjisë; b) iniciativave të deritanishme që tregojnë rezultate të shkëlqyera; c) sfidave dhe mësimave të nxjerra; dhe d) qasjes tek informacionet.

Me qëllim që të kihet parasysh edhe perspektiva e institucioneve kombëtare në raport të relevancës të rezultateve të marra nga intervista me komunat, SHQ PROAKTIVA realizoi edhe takime me përfaqësues të Agjencisë të Energjitikës.

Citojmë se Agjencia dhe pjesa më e madhe e komunave treguan kooperativitet të shkëlqyer dhe interes për transfertë të të gjitha informacioneve disponuese lidhur me politikat, praktikat dhe mësimet e nxjerra lidhur me efikasitetin energjetik dhe burimet ripërtëritëse të energjisë.

Më tepër detaje për rezultatet nga shqyrtimi, intervista dhe testimi i mekanizmave për qasje tek informacionet mund të gjeni në Analizën e cila u përgatit në kuadër të të njëjtit projekt.

4.1. Dokumente strategjike komunale për zhvillimin e efikasitetit energjitik dhe burimeve ripërtëritëse të energjisë



Duke i ndjekur detyrimet që dalin nga Ligji i Energjitikës, komunat janë të detyruara me ligj në përgatitjen e rregullt dhe të parashtrimit në kohë të tre dokumentave themelorë të lidhur me efikasitetin energjitik: a) programin trevjeçar për efikasitet energjitik; b) planet vjetore aksionale për efikasitet energjitik dhe d) raportet aksionale vjetore për efikasitet energjitik.

Ato komuna të cilat në kohë i parashtrojnë programet trevjeçare të tyre momentalisht janë në procesin e zbatimit të programit që mbulon periudhën 2015-2017 dhe fillojnë me procesin e përgatitjes së programit vijues trevjeçar i cili do të hyjë në fuqi nga vitit 2018 me kohëzgjatje deri në fund të vitit 2020.

Pjesa më e madhe e komunave në vazhdimësi përdorin kapacitete të jashtme për përgatitjen e programeve për efikasitet energjitik. Këtu është e domosdoshme që të përmendet se në kuadër të qytetit të Shkupit ekzistojnë edhe komuna që deri tani nuk kanë përgatitur program për efikasitetin energjitik dhe aspak nuk tregojnë interes për diçka të tillë në një të ardhme të afërt.

Megjithatë duhet përmendur se në kuadër të Qytetit të Shkupit ekziston një komunë e cila posedon kapacitete interne për zbatimin e procesit për përgatitje të pavarur të programit komunal për efikasitet energjitik. Pikërisht kjo komunë mund të theksohet si lider i cili mund të shërbejë si praktika më e mirë për përgatitjen e programeve për efikasitet energjitik me cilësi të lartë dhe në kohë.

Programet trevjeçare për efikasitet energjitik sipas Ligjit për energjitiqë janë të pasuara me plane përkatëse aksionale njëvjeçare për efikasitet energjitik. Tendencia e këtyre planeve është që të japin një implimentabilitet të qartë të programeve. Njëkohësisht, përgatitja e planeve aksionale është e lehtë për ta ndjekur në procesin e mëtejshëm të zbatimit të aktiviteteve të parashikuara, ndërsa me këtë edhe në zbatimin e programeve trevjeçare.

Si hap përfundimtar i cili e finishon procesin e ndërtimit të politikave komunale për efikasitet energjitik është detyra ligjore për parashtrimin e raporteve vjetore për zbatimin e aktiviteteve në fushën e efikasitetit energjitik. Kjo masë është mjaft e rëndësishme jo vetëm në aspektin e pasqyrës narrative dhe sasiore të avancimit të komunës në këtë sferë, por edhe për evidentimin e mësimave të nxjerra dhe para së

gjithash praktikave të mira që mund të shërbejnë si masa që janë lehtësisht replikabile në komunitet e tjera në mbarë vendin.

Pozicioni i PROAKTIVA-s lidhur me dokumentat komunale strategjike për efikasitet energjitik (dhe burimeve ripërtëritëse të energjisë) është si më poshtë:

- Po 1.1 Njësitë e vetëqeverisjes lokale (**komunitet**) në përgjithësi **nuk posedojnë kapacitete interne për përgatitjen e dokumentave strategjike** lidhur me efikasitetin energjitik dhe burime ripërtëritëse të energjisë.
- Po 1.2 Në përgjithësi, **programet komunale për efikasitet energjitik bëhen në mënyrë të pavarur nga programi i Qytetit të Shkupit**. Në këtë mënyrë **mungon procesi i sinkronizimit të programeve**. Njëkohësisht, një qasje e tillë çon drejt **izolimit të proceseve të zbatimit të masave** për efikasitet energjitik dhe përdorimit të burimeve ripërtëritëse të energjisë.
- Po 1.3 **Ekzistojnë komunitet** në kuadër të rajonit statistikor të Shkupit **që deri tani nuk kanë përgatitur program për efikasitet energjitik**. Të njëjtat **nuk i janë nënshtruar gjobave** për mosrespektimin e drejtimeve të përcaktuara me Ligjin e energjitikës. Njëkohësisht, kjo lloj qasje në mënyrë shtesë i stimulon ato, por edhe komunitet e tjera që të pranojnë një qasje të tillë me çka në perspektiva do të vërehet proces i ngecjes në planifikimin dhe zbatimin e masave për efikasitet energjitik.
- Po 1.4 Edhe pse në masë të madhe të varur nga interesi i agjencive donatore dhe organizatave internacionale me interes në sferën e efikasitetit energjitik; **komunitet** sërish **nuk investojnë në zbatimin e procesit të përgatitjes së programeve në partneritet të afërt me organizatat ndërkombëtare**. Në këtë mënyrë organizatat ndërkombëtare nuk e kanë ndjenjën e përgjegjësisë mbi programet dhe planet aksionale të komunave, ndërsa gjatë kësaj nuk shfrytëzohet edhe mundësia për sinkronizimin e programeve të cilat do të çonin drejt përfundimit të obligimit për zbatimin e mëtejshëm të masave me interes të përbashkët.
- Po 1.5 **Planet aksionale janë në përgjithësi të përgatitura në bazë ad-hoc**. Të njëjtat **në të shumtën e rasteve paraqesin pasqyrimin e masave që nuk janë zbatuar në vitin paraprak**. Me përjashtim të masave që janë të propozuara nga ana e organizatave ndërkombëtare të shoqëruara me përjashtim të tyre të fuqishme financiare, masat janë ose pasqyrohen nga plani aksional i vitit të kaluar ose paraqesin listën e dëshirave me mundësi të vogël për zbatim në praktikë.
- Po 1.6 Shqetëson fakti që **edhe pse masat për efikasitet energjitik me vite pas i tregojnë përparësitë e tyre**, si nga aspekti i kursimeve financiare edhe rritjes së cilësisë së jetesës, si edhe nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit të jetesës, **ekziston fakti se ende mungon investimi më intensiv në përdorim të masave për efikasitetin energjitik**.

- Po 1.7 Mjetet e kursyera nga përdorimi i masave për efikasitet energjitik dhe burime ripërtëritëse të energjisë në disa komuna janë evidentuar por në asnjë rast **nuk janë riinvestuar në të njëjtin sektor**. Në këtë mënyrë **komunat nuk kanë buxhet të vazhdueshëm për zbatimin e masave për efikasitet energjitik**, por varen nga interesi momental i trupave për vendim dhe në të shumtën e rasteve nga orgnizatrat ndërkombëtare që ofrojnë partneritet për zbatimin e masave me proporcion atraktiv të pjesëmarrjes financiare.
- Po 1.8 **Raportimi vazhdon të paraqesë dobësi si në shkallë kombëtare ashtu edhe në shkallë lokale**. Edhe pse raportet e parashtruara në Agjencinë e Energjitikës janë në bazë të dokumentave publikë, të rallë janë shembujt e komunave që tregojnë interes për paraqitjen publike të dokumentave.
- Po 1.9 **Shqyrtimi afatmesëm i programeve trevjeçare, evolucioni thelbësor i programit dhe planet aksionale njëvjeçare vazhdojnë të mungojnë**. Në këtë mënyrë nuk ka hapësirë për revizionin e programeve dhe as bëhet lidhje strategjike e të dy programeve pasuese përmes parimit qarkor të menaxhimit.
- Po 1.10 **Shoqatat e qytetarëve janë tërësisht të izoluara nga procesi i planifikimit dhe vendimmarrjes, ndërsa sa vjen dhe më pak marrin pjesë edhe në proceset e zbatimit të programeve komunale për efikasitet energjitik**.

REKOMANDIME:

- Re 1.1 Agjencia e Energjitikës duhet që të bëjë përpjekje në përforcimin e kapaciteteve komunale për përgatitjen e dokumentave strategjike për efikasitet energjitik. Nevojitet edhe lehtësimi i procesit të transmetimit të njohurive nga një komunë në tjetrën duke i niveluar kështu njohuritë, por njëkohësisht edhe krijimin e kushtve për lidhjen e partneriteteve afatgjata ndërkomunale. Në kontekst të Rajonit statistikor të Shkupit, PROAKTIVA mund të theksojë komunën e Kisella Vodës si një nga komunat më aktive e cila disponon me njohuri dhe përvoja në krijimin e programeve cilësore duke i përdorur vetëm kapacitetet teknike interne që ka në dispozicion.
- Re 1.2 Nevojitet përkrahje e fuqishme në procesin e sinkronizimit të programeve komunale për efikasitet energjitik me programin e Qytetit të Shkupit dhe planeve kombëtare të Republikës së Maqedonisë. Veçanërisht është e rëndësishme që të sigurohet pjesëmarrje thelbësore në Qytetin e Shkupit, në Agjencinë e Energjitikës dhe në Ministrinë e Ekonomisë.
- Re 1.3 Agjencia e Energjitikës është e detyruar që të gjejë mënyrë në të cilën do t'i sanksionojë komunat që nuk i përgatisin programet për efikasitet energjitik. Rekomandohet që fillimisht t'i jepet mundësi shtesë për përforcimin e kapaciteteve në këtë fushë, t'i mundësohet benifit ekonomik nga zbatimi i masave për efikasitet energjitik dhe të sigurohet mentor komunë e cila së bashku me Agjencinë do t'i çonte drejt procesit të përgatitjes të programit

për efikasitet energjitik. Nëse edhe kjo masë nuk siguron zbatimin e këtij detyrimi të Ligjit për energjitikë atëherë do të duhet që të merren sanksione të cilat do të ishin mjaftueshëm të fuqishme që të stimulojnë fillimin e procesit të planifikimit të aktiviteteve për përgatitjen e programit komunal për efikasitet energjitik.

- Re 1.4 Komunat do të duhet që të fillojnë t'i zbatojnë parimet e lidhjes së partneriteteve të afërta me organizatat ndërkombëtare me qëllim planifikimin dhe zbatimin e përbashkët të masave për efikasitet energjitik. Në Republikën e Maqedoniae ende janë të pranishme disa organizata ndërkombëtare që në kuadër të portfolios së tyre përfshijnë programe të fuqishme dhe të vazhdueshme për efikasitet energjitik. Këtu para së gjithash bëhet fjalë për GIZ, UNDP dhe Bankën Botërore. Në të shumtën e rasteve këto organizata praktikojnë partneritet në të cilat masat zbatohen përmes investimit të barabartë financiar. Kjo lloj qasje në komunat e Shkupit është e mjaftueshme që të sigurojë marrjen e vendimeve për inkuadrimit pa rezervë të zbatimit të masave të parashikuara. Në këtë mënyrë në 10 vitet e fundit rezultate të veçanta arritën komuna Qendër, Aerodrom, Karposh, Kisella Vodë dhe Gazi Babë. Këto komuna edhe më tej janë të gatshme për një lloj të tillë partneriteti për mobilizimin më aktiv të mjeteve, respektivisht sa vjen e më tepër ndjehet interesi i komunave për qasjen e tyre drejt organizatave ndërkombëtare me tashmë propozim projekte të përgatitura. Megjithatë, qasja duhet që të jetë më profesionale, e përkufizuar në mënyrë më strategjike, të jetë afatgjatë dhe e mbështetur edhe me programe të sinkronizuara.
- Re 1.5 Nevojitet intensifikimi i investimeve në zbatimin e masave për efikasitet energjitik. Masat për efikasitet energjitik tashmë nuk duhet që të jenë të arsyetuara. Ato janë vërtetuar dhe për ato shteti ka në dispozicion një sërë praktikash të mira të vërtetuara. Ajo që është e nevojshme është përfundimi i kapaciteteve të trupave që marrin vendime dhe gjithsesi afrimin e sektorëve për efikasitet energjitik, për zhvillim ekonomik lokal, financa, mjedisin e jetesës, punë komunale, qarkullim dhe infrastrukturë. Nevojitet edhe prezantim i qartë ekonomik në pikëpamje të kursimeve ekonomike.
- Re 1.6 Duhet të këmbëngulet që të vendoset një mekanizëm i qartë për riinvestimin e kursimeve financiare që janë marrë si rezultat i përdorimit të masave për efikasitet energjitik dhe përdorimin e burimeve ripërtëritëse të energjisë. Përkrahje e fortë është e domosdoshme nga ana e Ministrisë së Ekonomiks dhe Agjencisë të Energjitikës të përkrahur përmes shembujve me parametra të qartë ekonomike.
- Re 1.7 Nevojitet zbatimi i praktikave për revizion, vlerësim dhe raportim të rregullt të arritjeve nga zbatimi i programeve dhe planeve aksionale për efikasitet energjitik. Komuna duhet të ketë një pozicion të tillë ku programi dhe plani aksional të paraqesin vazhdim thelbësor të përcaktimit strategjik të komunës në sferën e efikasitetit energjitik dhe njëkohësisht edhe lidhje

teknike të programit paraprak për efikasitet energjistik dhe planet e saj aksionale.

Re 1.8 Shoqatat e qytetarëve duhet që të jenë pjesë e pandarë e proceseve të planifikimit dhe vendimmarrjes dhe gjithsesi duhet që të marrin pozicion strategjik në procesin e zbatimit të programeve komunale për efikasitet energjistik, informimin publik dhe rritjen e ndërgjegjes të qytetarëve.

4.2. Sfida dhe praktika të mira të komunave për zbatimin e masave për efikasitet energjitik

Diskutimet me personelin teknik të komunave qartësoi se në përgjithësi, të gjitha komunat ballafaqohet me të njëjtat sfida në sferën e efikasitetit energjitik. Mjetet financiare, procedurat administrative dhe mungesa e kuadrove të specializuar janë fushat të njohura si më problematike në zbatimin e masave që do të përforconin efikasitetin e komunave në pikëpamje të shfrytëzimit të energjisë.

Edhe përkundër asaj që masat për efikasitet energjitik treguan karakteristikat e tyre përmes realizimit të rezultateve të konsiderueshme si në aspektin ekonomik edhe në aspektin e mbrojtjes së mjedisit të jetesës, megjithatë mungesa e mjeteve financiare është ende sfida më e përmendur me të cilën ballafaqohen komunat. Nevojitet përforsimi i kapaciteteve të bartësve të vendimeve, themelimi i partneriteteve strategjike me donatorë potencialë dhe sigurimi i mekanizmave stimulues që institucionet kombëtare do t'i vinin në dispozicion të njësisë të vetëqeverisjes lokale.

Procedurat e rrepta administrative janë pengesë e vazhdueshme me të cilën ballafaqohen të gjithë personat teknikë që mbulojnë fushën e efikasitetit energjitik në komunat. Evidente është nevoja nga përforsimi i bashkëpunimit intersektorial përmes sigurimit të mekanizmave pragmatike për marrjen e vendimeve, lidhjes së marrëveshjeve dhe zbatimit të masave për efikasitet energjitik.

Kuadrot e specializuara është mangësia thelbësore në pjesën më të madhe të komunave. Nevoja e përforsimit të kuadrit disponues është më se evidente. Me rëndësi të veçantë është edhe krijimi i kushteve për punësimin e kuadrove të cilët janë të profilizuar për detyra të tilla. Rekomandohet krijimi i partneritetit të afërt midis komunave në të cilat personeli teknik këmben njohuri dhe përvoja, ka qasje drejt planifikimit të përbashkët, krijohet një marrëdhënie mentorimi derisa nuk barazohen kapacitetet, ka qasje drejt ndjekjes së përbashkët të zbatimit të masave që më tej të ketë akses në vlerësimin e asaj që është punuar para fillimit të procesit të ri të planifikimit në të cilin komuna mentor do të duhet që në tërësi të lërë komunën e targetuar vetë të bëjë procesin, ndërsa mentor organizata do të duhet që të luajë rolin e trupit këshillues.

Një nga sfidat me të cilat ballafaqohen komunat është edhe përdorimi i sistemeve të vetme informuese për ndjekjen dhe menaxhimin e energjisë konsumatore tek objektet e sektorit publik. Nga ana tjetër kjo sfidë ndikon negativisht ndaj institucioneve kombëtare dhe proceseve të tyre për krijimin e politikave kombëtare për efikasitet energjitik dhe burime ripërtëritëse të energjisë. Prandaj është i nevojshëm përforsimi i kapaciteteve të komunave për përdorimin e këtij mjeti ndërsa njëkohësisht edhe vendosjen e mekanizmit për menaxhim të integruar me sistem të vetëm informativ për ndjekjen e energjisë konsumatore në objektet me karakter publik.

Komunat në përgjithësi nuk kanë kapacitet për përlogaritjen dhe ndjekjen e uljes së emisioneve të gazrave të qelqta. Duke u nisur nga ajo që masat për efikasitet energjitik në të shumtën e rasteve planifikohen në kuadër të zhvillimit sektorial për zhvillim ekonomik, është e qartë se interesi i komunave është që të marrë të dhëna të

kuantifikuara për kursimet ekonomike ndërsa mbrojtja e mjedisit të jetesës dhe pjesëmarrja në uljen e emisioneve të gazrave të qelqta nuk paraqet ndonjë fushë të madhe interesi.

Politika të caktuara në shkallë kombëtare janë njohur si sfida të jashtëzakonshme për zbatimin e politikave komunale për vetë faktin se të njëjtat bëjnë presion negativ dhe ndikojnë shumë në gjendjen e komunave në pikëpamje të furnizimit me energji të objekteve publike në kompetencën e tyre. Kështu për shembull nga fundi i vitit 2009. Agjencia e Energjitikës së RM-së i ka ndryshuar normat e tarifave për energji termale për shkollat dhe kopshtet. Deri në vitin 2009 ato kishin norma të benifikuara tarifore, respektivisht kishin norma më të lira tarifore se amviseritë. Me vendimin e marrë nga fundi i dhjetorit të vitit 2009, normat tarifore të kopshteve u rritën për 350% ndërsa normat tarifore të shkollave për 250%. Në këtë mënyrë kopshtet dhe shkollat u barazuan me operatorët ekonomikë (firmat). Gjatë kësaj duhet të kihet parasysh se financat e nevojshme për mbulimin e energjisë për kopshtet dhe shkollat, komuna i merr përmes bllokut të shtesave nga Qeveria e RM-së. Ajo që ndodhi nga vitit i ardhshëm është se paratë që komuna i merr nga Qeveria për këtë qëllim mbetën të njëjta, ndërsa shpenzimet u rritën në mënyrë enorme.

Lista e sfidave me të cilat ballafaqohen komunat është e gjatë por megjithatë e domosdoshme është që të përmendet se në dhjetëvjeçarin e kaluar një numër i madh u komunave që bëjnë pjesë në Rajonin statistikor të Shkupit treguan interes të dhe angazhim të jashtëzakonshëm në planifikimin dhe zbatimin e masave aktive për efikasitet energjitik. Në vazhdim do të përmendim disa komuna të cilat arritën rezultate të shkëlqyera dhe njëkohësisht janë tërësisht replikabile.

Komuna e Kisella Vodës i përgatit programet dhe planet aksionale për EE.

Komuna disponon me kapacitete interne me cilësi të lartë që në mënyrë të vazhdueshme përballen me sfidën që vetë të përgatisin programe trevjeçare dhe plane aksionale vjetore për efikasitetin energjitik. Duke përdorur presonelin e vet teknik komuna këmbëngul që gjatë përgatitjeve të këtyre dokumentave të respektohen postulatet e qëndrueshmërisë ndërsa përsëri të ketë qasje pragmatike. Programi dhe plani aksional janë vazhdimësi thelbësore e përcaktimeve stategjike të komunave në sferën e efikasitetit energjitik dhe ndërlidhje teknike e programeve paraprake dhe planeve të saj aksionale.

Komuna Qendër përpiqet që ta tejkalojë qasjen parciale të zbatimit të masave të EE-së.

Shkolla "11 Tetori" u përfshi me masat për adresimin e sfidave me fasadën dhe dritaret. Ajo që është interesante në këtë rast është se komuna Qendër e dalloi problemin me kanalet e jashte të ventilimit të cilët luanin rolin e urave ajrore (në pajtim me dedikimin e tyre të planifikuar paraprakisht në këtë objekt - spital). Me humbjen e destinimit paraprak, objekti tregonte humbje enorme të energjisë, para së gjithash energjisë termale. Për këtë arsye përveç sanimit të fasadës dhe ndërrimit të dritareve, komuna i përfshiu edhe masat për bllokimin e këtyre urave. Si rezultat vetëm me bllokimin e urave, objekti pati kursim prej mbi 40%.

Komuna e Gazi Babës e integron efikasitetin energjistik në kuadër të sistemeve për trajtimin e ujërave të zeza.

Me rëndësi të veçantë është që të citohet qasja inovative për ndërtimin e rrjetit të vakumit të ujërave të zeza. Domethënë, komuna parashikoi në kuadër të projektit të përdorë teknologji adaptuese hungareze përmes të cilës sigurohet një gërmim më sipërfaqësor se modeli klasik. Kjo në thelb nënkupton jo vetëm që i minimizon rreziqet që dalin nga fakti se ujërat e zeza në rajonin e Shkupit janë mjaft afër sipërfaqes por njëkohësisht edhe vetë sistemi për trajtimin e ujërave të zeza e rrit efikasitetin e tij energjistik me vetë atë që pompat janë të vendosura më në sipërfaqe dhe nuk kanë nevojë për kërkesë më të madhe të energjisë për kryerjen e funksionit të tyre themelor.

Qyteti i Shkupit formoi Info Qendër për energjistikë, efikasitet energjistik dhe burime ripërtëritëse të energjisë

Në kuadër të sektorit për Zhvillim ekonomik lokal, Qyteti i Shkupit në vitin 2011 e formoi Info Qendrën për energjistikë, efikasitet energjistik dhe burime ripërtëritëse të energjisë. Bëhet fjalë për qendër e cila i jep këshilla falas qytetarëve me qëllim të zbatimit të masave të thjeshta por edhe më të ndërlikuara me të cilat do të rrisnin efikasitetin e shtëpive të tyre dhe vendeve të tyre të punës. Kjo masë u tregua si një masë mjaft e lirë me rezultat të madh e cila rezoltoi me rritjen e interesit të qytetarëve ndërsa gjatë kësaj kapacitetet njerëzore të kësaj qendre në tërësi i ndihmuan politikat komunale për efikasitet energjistik dhe burime ripërtëritëse të energjisë.

Komuna qendër vendosi subvencione për stimulimin e përdorimit të biçikletave.

Kjo masë u bë një nga masat më të njohura për stimulimin e zhvillimit të transportit të qëndrueshëm në rajonin qendror të qytetit. Duke i analizuar rezultatet e kësaj mase dhe duke e testuar interesin e qytetarëve, Qyteti i Shkupit vendosi që ta pranojë dhe replikojë këtë model duke e përhapur idenë nga rajoni qendror i Qytetit në mbarë territorin e qytetit të Shkupit. Interesante është të citohet se indikatorët për përdorimin e kësaj mase treguan interes të jashtëzakonshëm dhe rezultat i cili siguroi vazhdimësi të kësaj mase. Përndryshe kjo masa është lehtësisht replikabile për çdo komunë në mbarë territorin e Republikës së Maqedonisë.

Qyteti i Shkupit zbatoi masa për gazifikimin e shkollave të mesme.

Gazifikimi i shkollës së mesme Gjorgji Dimitrov dhe Zdravko Cvetkovski tregoi rezultate të shkëlqyera dhe që këtu edhe vazhdohet ky aktivitet në kuadër të shkollave të mesme Zef Lush Marku dhe Arsenij Jovkov. Përkundër emisioneve të ulëta të gazrave të qelqtë, gazifikimi si masë tregon edhe kursime të mëdha financiare që në këtë periudhë arrijnë 70-80 për qind dhe një kthim shumë të shpejtë të investimit. Gjithsesi arsyet nuk qëndrojnë vetëm në aplikimin e kësaj mase por edhe në çmimin paraprak të energjisë termale dhe humbjet e rrituar të nxehtësisë gjatë distribuimit që përmes kësaj mase ishin minimizuar tërësisht. Komuna përdori kësaj me 96% shfrytëzim. Me këtë payback periudha arrin 3-4 muaj.

Qyteti i Shkupit vendosi regullacion të shkallës së dytë të objekteve nën kompetencat e tij.

Regullacioni i shkallës së dytë filloi me zbatim në vitin 2010. Për këtë masë komuna pagoi 70.000 MKD në vit për objekt por me këtë u kursye një sasi e konsiderueshme e

energjisë elektrike. Është interesante që të përmendet se këtë vit Qyteti i Shkupit nënshkroi marrëveshje me BEG për udhëheqje falas të rregullacionit të shkallës së dytë dhe që këtu pritet që edhe investimet për këtë masë do të përjashtohen ndërsa kursimet do të vazhdojnë të gjenerohen.

Komuna e Kisella Vodës përdor softuer individual për përlllogaritjen e karakteristikave energjitike për ndërtesa.

Komuna e Kisella Vodës ka kapacitete interne për përlllogaritjen dhe ndjekjen e uljes së emisioneve të gazrave të qelqta si rezultsat i zbatimit të masave për efikasitet energjistik. Informacionet ruhen në formë elektronike dhe janë të disponueshme për palët e interesuara.

Komuna e Kisella Vodës mban statistikë të plotë për energjinë konsumatore për çdo objekt publik më vete. Të dhënat kanë të bëjnë me shpenzimet për ngrohje dhe energji elektrike, ndërsa në mënyrë shtesë konfirmohen edhe nevojat dhe shpenzimet për ndriçimin rrugor. Të dhënat që llogariten në shkallë mujore janë të klasifikuara në kuadër të bazës së veçantë të të dhënave të bëra nga këshilltari për efikasitet energjistik i komunës.

Komuna e Kisella Vodës pati qasje drejt partneritetit strategjik me UNDP, GIZ dhe Bankën Botërore përmes dokumentacionit të përgatitur teknik për çdo objek dhe me pjesëmarrje financiare të përgatitur në zbatimin eventual të projekteve të propozuara. Kjo qasje në masë të madhe dha rezultate. Raporti më i shpeshtë i pjesëmarrjes financiare të komunës lëviz nga 30-60 %.

Komuna e Kisella Vodës futi sistem për menaxhim energjistik (Energy Management) të ndërtesës komunale dhe një pjesë të objekteve publike. Në thelb kjo masë paraqet menaxhimin, rregullimin dhe ndjekjen e dërgesës të energjisë. Sistemi i Toplifikimit është sipas energjisë së jashtme dhe si i tillë është i njohur si një sistem shumë i rëndë i cili kërkon balancim të rregullt/të shpeshtë. Vendosija e këtij sistemi në parim kushton rreth 700 EUR (investim afatshkurtër), ndërsa rezultatet treguan se kursimet e energjisë arrinin madje deri në 50 për qind.

Rekomandohet rregullimi i temperaturave në pajtim me të dhënat që vijnë nga senzori i hapësirës më të ftohtë (ku ekziston ana e cila nuk kapet nga dielli –ana veriore) ku nëse atje arrihet temperatura deri në 20° në këtë rast në mjediset e tjera do të arrihet mesatare prej 22° . Vetë ajo që sistemi shkyçet gjatë ditëve pushim dhe gjatë kohës kur nuk punohet vjen deri në uljen e konsumimit në 30-32%. Me vendosjen e rregullacionit të shkallës së dytë dhe kontrollin në kuadër të kohës së punës, kursimet rriten në 50 për qind. Një praktikë e tillë është replikabile për të gjitha komunat e tjera dhe për këtë arsye u promovua para komunave dhe një pjesë e tyre e pranuan një praktikë të tillë.

Komuna e Kisella Vodës lidhi partneritet proaktiv afatgjatë me TITAN- Fabrikën e Çimentos Usje. Në kuadër të programeve të tyre vjetore për përgjegjësinë komunale korporative, TITAN investon mesatarisht nga 50.000 EUR në vit për zbatimin e masave për efikasitet energjistik në pajtim me nevojat e komunës. Këtu rezultatet janë zakonisht të garantuara për arsye se ato kanë në dispozicion materialet e nevojshme për izolimin e jashtëm. Ky lloj shembulli për krijimin e partneriteteve me sektorin privat është me

rëndësi të madhe gjatë paraqitjes së praktikave më të mira drejt të cilave duhet të synojnë të gjitha komunat. Kuptohet, një qasje e tillë e komunave nuk do të ishte e mundur nëse nuk ekziston një personel teknik me cilësi të lartë dhe kryetar komune/kryetare komune përgjegjës/përgjegjëse.

4.3 Qasje në informacione

PROAKTIVA në kuadër të zbatimit të aktiviteteve projektuese vërejtji praktika të ndryshme të komunave në qasjen tek informacionet. Kryesisht, një pjesë e komunave nuk konsideronin se është e nevojshme që t'i përgjigjen pyetjeve që ishin parashtruar në mënyrë zyrtare në administratën e tyre. Nga ana tjetër komuna të tjera jo vetëm që i dhanë përgjigje pyetësorit por bënë edhe përpjekje dhe harxhuan kohë që të japin një raport të hollësishëm lidhur me kërkesën.

Gjatë analizës të informacioneve publikisht të qasshme në faqet zyrtare të internetit u nxorr një konkluzion i ngjashëm. Një pjesë e komunave nuk kanë aspak faqe aktive interneti. Një pjesë e komunave të tjera kanë faqe interneti me përafërisht informacione të shumta për dokumentat dhe masat që janë zbatuar.

Në përgjithësi, këto komuna ende nuk kanë interes për përgatitjen e dokumentave strategjike për efikasitet energjistik si dhe nuk investojnë në zbatimin e masave për efikasitet energjistik, por njëkohësisht nuk kanë as interes për inkuadrimin e çfarëdo lloji informacioni në këtë fushë.

Shembulli më i shpeshtë për transmetimin e informacione në pikëpamje të zbatimit të masave për efikasitet energjistik është përdorimi i mediave përmes shfrytëzimit të kapaciteteve të kryetarëve të komunave/kryetareve të komunave dhe personave të autorizuar për komunikim me opinionin.

Rekomandime:

- Re 3.1 Komunitat do të duhet që në kuadër të faqes së tyre të internetit të veçojnë një vend të caktuar i cili do të jetë për hedhjen e informacioneve të fokusuara në: a) programet për efikasitet energjistik; b) planet aksionale për efikasitet energjistik, c) raportet vjetore për zbatimin e programeve dhe planeve aksionale; d) arkiv të projekteve të zbatuara për efikasitetin energjistik dhe burimet ripërtëritëse të energjisë; e) listë dhe përshkrim të projekteve vijuese në fushën e efikasitetit energjistik dhe burimeve ripërtëritëse të energjisë.
- Re 3.2 Agjencia e Energjitikës si institucion kombëtar, kompetente që t'i shqyrtojë dhe miratojë dokumentat strategjike komunale në fushën e efikasitetit energjistik do të mundet që t'i mbulojë informacionet e mëposhtme: a) programet komunale trevjeçare për efikasitet energjistik; b) plane aksionale për efikasitet energjistik; c) raporte vjetore për zbatimin e programeve dhe planeve aksionale; d) lista dhe përshkrime të hollësishme të masave që janë të njohura si praktika më të mira që njëkohësisht janë replikabile në komunat e tjera në mbarë vendin.

Kjo lloj qasje do të mundësonte përforcimin e transparencës, rritjen e informimit të qytetarëve, mundësimin e qasjes të informacioneve më të hollësishme për komunat të cilave u nevojiten njohuri dhe përvoja të praktikave më të mira të zbatuara për efikasitetin energjetik. Njëkohësisht një sistem i tillë përmes përkrahjes nga ana e faqes së internetit të Agjencisë do të siguronte parashtrimin në mënyrë të vazhdueshme të informacioneve madje edhe në rastin kur komuna të veçanta nuk kanë faqe aktive të internetit ose nuk kanë interes apo hapësirë për hedhjen e këtyre informacioneve.

Në fund është e rëndësishme të përmendet se numri më i madh i komunave bëjnë përpjekje për transmetimin e informacioneve që ishin kërkuar gjatë intervistave.

5. Konkluzione

Analizat dhe intervistat me përfaqësuesit e institucioneve kombëtare dhe lokale gjatë procesit të përgatitjes së këtij dokumenti, siguruan kushte që PROAKTIVA të nxjerrë një sërë konkluzioneve prej të cilave numri më i madh janë reflektuar në kuadër të dokumentit.

Në vazhdimësi citojmë disa konkluzione të veçuara për të cilat konsiderojmë se kanë interes vital për përf forcimin e proceseve që çojnë drejt vendosjes së një mekanizmi të qëndrueshëm kombëtar dhe komunal për zhvillimin e efikasitetit energjitik dhe përdorimit të burimeve ripërtëritëse të energjisë.

Edhe pse në kuadër të dokumentit janë dhënë rekomandime për tejkalimin e sfidave, megjithatë në këtë pjesë konkluzionet janë shfletuar vetëm në formë të konstatimeve për arsye se duam të lëmë hapësirë për një seri të takimeve të hapura të palëve të interesuara në të cilat hapur do të flitet për të gjitha çështjet e hapura në kuadër të këtij kapitulli dhe në kuadër të dokumentit në tërësi.

Dokumentat strategjike për efikasitet energjitik janë fokusuar në elaborimin e hollësishëm teknik të informacioneve. Ngjasojnë në programe dhe plane aksionale. Në to mungon thelbi, ndryshimet e planifikuara strukturore, mekanizmat inetrne, shfaqja e partneriteteve strategjike të planifikuara dhe/ose të vendosura, ndërsa mungon edhe shqyrtimi, revizioni dhe njoftimi vjetor i masave të zbatuara.

Programet kombëtare dhe komunale nuk janë të sinkronizuara. Mungesa e sinkronizimit është e evidente edhe midis komunave të cilat bëjnë pjesë në të njëjtin rajon statistikor. Kjo lloj praktike paraqitet edhe midis Qytetit të Shkupit dhe komunave që bëjnë pjesë në rajonin e tij. Sinkronizimi mungon edhe midis dokumentave strategjike të institucioneve të ndryshme kombëtare në të cilat pritet që Ministria e Ekonomisë dhe Agjencia e Energjitikës të përfshijnë axhendën e tyre.

Partneritetet strategjike me sektorin privat dhe civil janë të përjashtuara. Përkundër asaj që tashmë karakteristike për strategjitë është se sektori civil është krejtësisht i përjashtuar nga proceset për planifikim dhe vendimmarrje, shqetëson tendenca se ky sektor shmanget të njihet edhe si partner në proceset e zbatimit të masave.

Partneriteti me organizatat ndërkombëtare ad-hoc pa sigurimin e procesit të përbashkët të planifikimit afatgjatë dhe sinkronizimit të programeve ku donatorët potencialë nuk kanë ndjenjën e pronësisë mbi politikat komunale dhe si rrjedhojë e kësaj nuk kanë edhe angazhime të ngjashme për zbatimin e planeve komunale.

Dokumentat strategjike në shkallë kombëtare dhe komunale nuk flasin aspak për masa inovative. Njëkohësisht, këto dokumenta nuk flasin as për mësimet e nxjerra dhe praktikën më të mira të cilat do të përshpejtonin procesin e arritjes të qëndrueshmërisë në shkallë kombëtare dhe komunale.

Institucionet kombëtare dhe njësitë e vetëadministrimit lokal (komunat) përgjithësisht nuk posedojnë kapacitetet intern për përgatitjen e dokumenteve strategjike lidhur me efikasitetin energjitik dhe burimet ripërtëritëse të energjisë.

Masat për efikasitet energjitik evidentojnë kursime të mëdha financiare lidhur me nevojën për energji por kursimet e marra nuk riinvestohen në vazhdimin thelbësor të masave për efikasitet energjitik.

Fondi për efikasitet energjitik ende mbetet vetëm dëshirë e cila vetë në vetvete merr shumë kohë dhe përfshirje inkluzive të shumë personave, institucioneve dhe organizatave.

Republika e Maqedonisë ende nuk ka themeluar **ESKO kompani**. Tregu i energjisë elektrike ende nuk është liberalizuar. Nuk ka model të ri dhe kuota për prodhues të autorizuar të energjisë elektrike përmes përdorimit të energjisë diellore.

Komunat në përgjithësi nuk posedojnë kapacitete interne për përlllogaritje dhe ndjekje të emisioneve të ulura të gazrave të qelqtë si rezultat i zbatimit të masave për efikasitetin energjitik. Praktikë është që rezultatet të ndiqen vetëm nga perspektiva e kursimeve financiare.

Sistemi për menaxhimin e integruar me energji në objektet publike është masa e cila tregon rezultate të jashtëzakonshme por i njëjti nuk është i replikuar në kuadër të asaj që pritej.

Qasja në informacionet e mundësuar nga ana e komunave është e pakënaqshme. Njëkohësisht, kapacitetet dhe interesi i kuadrit teknik në komunat në masë të madhe varion, kështu që kemi një numër të madh të komunave që në të vërtetë as nuk i kuptojnë kërkesat, as posedojnë informacione të mjaftueshme për të njëjtat dhe as paraqesin dëshirë që të investojnë në përf forcimin e kapaciteteve individuale.

Në fund do të përmendim se në periudhën e fundit bëhet kritike çështja e konfliktit eventual midis investimit në përdorimin e hidrocentraleve edhe në mbrojtjen e natyrës. Kjo çështje krijoi keqkuptime të mëdha dhe konflikt direkt midis institucioneve kombëtare dhe shoqatave të qytetarëve në sferën e mbrojtjes së natyrës.

I dërgojmë një falenderim të madh Bashkimit Evropian dhe ekipit të përbërë nga Milieukontakt, Kocka dhe Front 21/42 për mundësinë e treguar që t'i parashtrijmë qëndrimet tona në raport me politikat kombëtare dhe komunale për efikasitetin energjitik.

PROAKTIVA mbetet e hapur për komente dhe vërejte në këtë dokument dhe shpreson në fillimin e diskutimeve të hapura të kryesuara nga ana e institucioneve kombëtare dhe komunale me qëllim të qasjes pragmatike drejt tejkalimit të përbashkët të sfidave dhe bashkimit të forcave drejt zbatimit të ideve dhe planeve të përbashkëta.

Për më shumë informata:**Detaje për kontakt për zbatuesin e projektit**

Vladimir Karchicki, kryetar

Shoqata e qytetarëve PROAKTIVA, Shkup

P. Fax 695, 1000 Shkup

Tel: +389 (0)76 40 40 76

Email: info@proaktiva.org.mk

Kontakt detaje të Delegacionit të Bashkimit Evropian

rr. Sv. Kiril i Metodij 52b, 1000 Shkup

Tel: +389 (0)2 3248 500

fax: +389 (0)2 3248 501

Email: delegation-fyrmacedonia@eeas.europa.eu